



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 48, datë 11.11.2015

Për

**“KRIJIMIN E TIRANA PARKING SI INSTITUCION NË VARËSI TË BASHKISË  
TIRANË PËR ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT TË PARKIMIT PUBLIK ME  
PAGESË”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 1/VI, shkronja “b”, pika 1/I shkronja “ç”, nenit 16, pika 3, shkronja “a”, nenit 32, shkronjat “ç”, “d”, “dh” dhe nenit 33, pika 3 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 7, pika 8, shkronja “a”, nenit 37, pika 1, shkronjat “b” e “c” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 527, datë 20.07.2011 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 28, datë 23.12.2014 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë krijimin e Tirana Parking, si institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës. Detyrat kryesore institucionale e funksionale të këtij institucioni do të jenë si më poshtë vijon:
  - a. të administrojë shërbimin e parkimit publik me pagesë të Bashkisë së Tiranës, mbi tokë dhe nëntokë, në përputhje me zonat e përcaktuara për këtë qëllim;
  - b. të planifikojë dhe të ndjekë zbatimin e investimeve në infrastrukturën e nevojshme për shërbimin e parkimit publik me pagesë në Bashkinë e Tiranës;
  - c. të instalojë dhe mirëmbajë pajisjet dhe makineritë e parkimeve me pagesë;
  - ç. të instalojë dhe mirëmbajë sinjalistikën rrugore të parkimit;
  - d. të konstatojë dhe të vendosë gjoba për kundërvajtjet administrative lidhur me qëndrimi përtej orarit të caktuar dhe mospagesën e tarifës së parkimit;
  - e. të arkëtojë gjobat e vëna në kuadër të konstatimit të një kundërvajtje administrative për shkelje që kanë të bëjnë me parkimin;
  - f. të kryejë çfarëdo lloj aktiviteti tjetër që nuk bie në kundërshtime e që lidhet direkt apo indirekt me përmbushjen e detyrave institucionale e funksionale, si dhe të kryejë detyrat që i ngakohen njësisë së qeverisjes vendore në kuadër të administrimit të parkimit tokësor dhe nëntokësor me pagesë;
  - g. t’i propozojë Bashkisë së Tiranës përmirësimin e politikave të administrimit të parkimit tokësor dhe nëntokësor me pagesë.